



Prishtinë, 18 shtator 2008
Kodi i ZRRE-së: V_124_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 15.2 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenit 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike
3. Kërkesës për aprovim të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes KOSTT SH.A. të datës 02 korrik 2008, **në seancën e mbajtur me date 18 shtator 2008, nxori këtë:**

VENDIM

I. APROVOHET Kodit i Shpërndarjes dhe Kodi i Matjes për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) më datë 02 korrik 2008 ka pranuar kërkesën për aprovim të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes së OSSH.
2. ZRRE ka shqyrtuar Kodin në fjalë, dhe pas plotësimit e ka aprovuar atë.
3. Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEK SH.A. duhet të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e nxjerrjes apo data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Nysret Avdiu, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare